




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe në pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

THËRRET

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 01.04.2025, (ditë e marte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë: REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z.Vaughan Smith, Nr.02-170-01-0010227/25, të datës 17.03.2025, (Raporton Kryetari i Komunës **z.Fadil Nura**),
5. Propozim-vendim për ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave të ofruara nga KRU, "Uniteti", Sh.A. Mitrovicë, (Ndryshimin dhe plotësimin e nenit 18 paragrafi 1.1 shtojca A, të Rregullores Nr.01-110/04-0005958/23, të datës 31.01.2023 për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Skenderajt), me Nr.02-352/01-0010872/25, të datës 24.03.2025, (Raporton Kryetari i Komunës **z.Fadil Nura**),
6. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.



KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr. 01-060/01-0010722/25
Data 21.03.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 27.02.2025, ora 10:00

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës i ekzekutivit për vitin 2024, me Nr.02-052/01-0007264/25, të datës 20.02.2025, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
5. Propozim-vendim për mbështetje financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale "Eko-Natyrë", Sh.A. Skenderaj, me Nr.02-404/02-0007012/25, të datës 21.02.2025, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
6. Informatë mbi shërbimet e dhëna nga QKMF, QMF dhe AMF, Janar - Dhjetor 2024, me Nr.08-400/01-0006875/25, të datës 18.02.2025, (Raporton drejtori i DSHMS-së, **z.Shahin Tahiri**);
7. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu: Të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, kërkojmë falje për mungesë të kryetarit po është një takim në Prishtinë, shkojmë në konstatime të kuorumit, në sallë janë 26 anëtar, mungojnë me arsye Ervina Vojvoda dhe Kushtrim Draga, bashkëngjiten mbledhjes Ragip Durmishi, Armir Sejdiu dhe Alketa Mecini. -Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, nëse nuk ka, shkojmë në votim; Konstatohet me (16) vota për, (4) kundër dhe (5) abstenim, miratohet Rendi ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hap debatin, nëse nuk ka shkojmë në votim; Konstatohet me (15) vota për, (0) kundër dhe (8) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Ju njoftojmë së Alketa Mecini është bashkangjitur seancës.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës i ekzekutivit për vitin 2024, me Nr.02-052/01-0007264/25, të datës 20.02.2025, (Në mungesë të kryetarit, Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Fjala përshëndetëse, në mungesë të kryetarit po e raportoj Raportit vjetor i punës i ekzekutivit për vitin 2024, siç e dini raporti i punës së ekzekutivit është një obligim ligjor për kryetarin e komunës që të raportoj për punën e kryer gjatë vitit. Puna e kryer ekzekutivit është me 12 drejtori dhe 3 zyra, ku se cila drejtori e ka hartua në detaj pjesën e vetë, që është pjesë e këtij raporti. Detyrat e punës kanë qenë të bazuara në buxhetin e vitit 2024. Gjitha pyetjet eventuale brenda këtij raporti mundën me u përgjigj së cili drejtor për drejtorin e vetë.

Kryesuesja: Faleminderit drejtor, e hap debatin, fjalën ja kaloj;

Afrim Kabashi-NSD: Përshëndetje të nderuar koleg të ekzekutivit, si dhe të legjislativit. Të nderuar koleg të ekzekutivit ju na keni ofruar një raport vjetor të punës të ekzekutivit për vitin

2024 ku edhe kemi ne këtë seancë të diskutojmë dhe ti paraqesim opinionet tona lidhur me këtë raport. Në raportin të cilin na e keni ofruar sot ne diskutim me shume kemi te bëjmë raport të përmbledhjeve të punëve ditore që kryhen nga stafi, sesa realizim të projekteve konkrete të realizuara. Unë e Kam lexuar raportin dhe kam disa për të diskutuar ku edhe kërkoje informata shtese pasi që nuk i kemi këto informata nuk i kemi ne raport që na e keni ofruar e ku u deshtë të jene edhe si pune apo projekte të pakryera.

Edhe pse kryetari Nura nuk të është i pranishëm ne seancë e ku kam pyetje apo informata shtese këtë pyetje ju drejtohem Kryesueses Adelina Spahiu. A ka mundësi të njoftohemi cilat janë arsyet e mosfunksionimit e komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave i formuar nga kuvënd ne seancën e datës 28.03.2024 dhe i plotësuar me anëtarë të opozitës pas rekomandimit nga MAPI.-ja me datë 07.06.2024. Për Drejtorin për Urbanizëm Driton Mulaj; Ne raportin tuaj të projekteve të realizuara ne vitin 2024 thekson se janë realizuara disa projekte që ke cek, e të cilat po me duket e kanë fatin e njëjtte të paralizuar posi rruga Dashefc-Polac si dhe rruga Rakinic-Qubrel të cilat kanë figurua por asgjë s'është krye. Ke theksuar ne raport se është kryer punimi i rrjetit të ujësjellësit në f.sh Burojë, ndërsa sipas qytetarëve të të ati fshati aje projekt nuk është realizuar, andaj është mire që kolegja që është e pranishme ne seancë e që vjen nga aj lokalitet Besiana Thaçi të na e vërtetoni a është realizuar projekti i ujësjellësit në Burojë apo jo. Projekt tjetër që ke theksuar i realizuar apo ne realizim është asfaltimi i rrugëve ne Polac andaj dua të njoftohemi ku është bere asfaltim në Polac pasi që unë nuk Kam njohuri ku është asfaltuar. Tek ndriçimi publik që ne raport ke theksuar i realizuar ne Polac unë dua të njoftohem a është projekt i realizuar i kryer apo do të vazhdoje, pasi që sipas punëve të kryera ka disa lagje të cilat fare nuk janë të kyçura ne këtë projekt, si dhe rrugët anësore ne asnjë lagje nuk janë realizuara punët.

Te pjesa e kanalizimit ne Polac besoj që ju Drejtor e dini mire gjendjen ne teren ku shume lagje kanë mbete pa u kyçur ne rrjetin e kanalizimit dhe të cilat kërkojnë zgjidhje pozitive të projektit. Tek Drejtorja e Bujqësisë kam disa pyetje, por pasi që drejtori Behxhet Maliqi nuk qenka i pranishëm këto pyetjet do ti drejtoje ne ndonjë seancë tjetër ku do të jetë i pranishëm personalisht drejtori. Për Drejtorin e Inspektoratit dhe Drejtorin e Shërbimeve Publike kam pyetje të përbashkët për të dyte. A ka mundësi të njoftohemi a është marre ndonjë mase ne ngritjen e çështjes lidhur me përmasimin e gjendjes së Lumit Klina ne pjesën pas fabrikës së ujerave të zcra në Llaushe e deri ne Rezall të re e ku kundërmon ere e rende, e ku disa here e kemi pasur shqetësime të banorëve të ati lokaliteti. E këtë çështje e kam ngrite edhe një here në vitin 2024 konkretisht ne seancën e datës 25.09.2024. Po ashtu drejtor a keni marre ndonjë mase ne inspektim dhe a keni bere ndonjë kallëzime penal apo gjobe për shkakaret dhe keqbërësit ne dëmtimin e hapësirave publike duke e gjuajtur mbeturina dhe materialë inerte vend e pa vend dhe duke e ndotur natyrën. Te nderuar koleg faleminderit dhe besoj që me keni kuptuar drejte ne diskutimin tim.

Hysni Mehani-VV: Fjala përshëndetëse, me qenë së nuk është as kryetari as nënkryetari, nuk kemi me kanë me ballafaqua këtë raport, dhe shtesë tjetër është së ky raport edhe me ballafaqua është shumë i varfër, është ekzagjerua dhe ka shume të pa vërteta, po edhe në ato ekzagjerime në ato të pavërteta prapë është qaq i varfër, nuk ki qysh e kundërshton, është thatë, shih çka thotë z. Nura në kuadër të punëve, tu e përmend Pendën e Kuqices, që në fund fjalinë e dytë thotë, që së ka as një rolë për këtë punë, atëherë përse, nëse nuk e ka as një rol për këtë punë atëherë përse po e shtinë në suaza të punëve për vitin 2024, tërë kohen e ka shajhtë qeverinë për mungesë të financimit e ndërkohe në faqen e parë të raportit e përmend punët e qeveris.

Me gjithë atë keni legjitimitet të njerëzit po ju votojnë, për këtë farë mënyrë qysh po qeverisni, edhe vazhdoni kështu përderisa kohe ju votojnë. Ajo çka është shume e rëndësishme që do duhej

me qenë në suaza të këtij raporti me na tregua që ky kabinet i juaj ekzekutiv sa aktakuza i ka, na e dimë që një drejtor është dënuar, njo dy i pamë tu knu si bylbyli tu e pranua fajin.

Kryesuesja: Hysni janë organet kompetente që merren me këtë çështje, lidhu në pikë të rendit të ditës, me raportin e punës, së me detyron me ta ndal fjalën.

Hysni Mehani-VV: Nuk ma ndal fjalën po mos me pengo, jam në pikë të rendit të ditës, jemi tu fole për raport të punës të vitit 2024, dhe për aktakuzat gjatë kësaj pune, dhe njerëzit kanë aktakuza për këtë plan pune. Sa aktakuza i ka qeverisja juaj? Po me interesojnë edhe çështjet specifike, janë trajtua me eutanazi 45 qen, çka nënkupton kjo? Është dhënë vend gjyctic, a mundesh me na tregua kujë është dhënë dhe sa është vlere e kësaj vend gjyctic? Drejtoria për zhvillim ekonomik ka pas një farë raporti kontaktual me UNMIK-un, cila është qasja e qeveris të juaj me UNMIK-un? Edhe çka me shqetëson dhe nuk e kam të qartë janë vërtetime për 283 armbajtje, unë e di që lejjet për armë i lëshon MPB, çka nënkupton ky vërtetim?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Sa i përket pjesës së projekteve kapitale ne detal janë të shpalosura gjitha projektet dhe gjitha punët e kryera sa i përket investimeve kapitale për vitin 2024, edhe me shifra edhe me financa, pjesa tjetër ka mbet të realizohen gjatë vitit 2025 gjitha ato projekte që janë në vazhdim. Gjitha ato që janë të shënuara sigurisht së qëndrojnë për punët që i ka kryer, sa i përket këshillave lokal neper fshatra është aspekti financiar që ka ndryshua ligji i pagave, që ka bërë të kemi kufizime në financim që i ka përjashtua të gjitha kategoritë për pagesa eventuale tjera, që është një neglizhencë dhe nuk po gjejmë bazë ligjore, se si me i financuar.

Drejtori i DUMA-së, Driton Mula: Fjala përshëndetëse, Afrim, rruga Dashec-Polac ka qenë projekt 2022, dhe nuk ka qenë projekt 2024, është punua diku 850m, me zhavor është kryer 850, vetëm janë hapë transet. Rruga Rakinic-Qubrel edhe ky ka qenë projekt 2022-23 është shtrua diku 1500m, dhe disa rrugë tjera janë trajtua dhe nuk është projekt i 2024. Ujësjiellësi në Burojë ka përfundua pjesa parë, kanë qenë dy kontrata, kontrata e parë ka qenë ujësjiellësi në Burojë, Dashec, në Kryshec besoj që kemi me fillua tash, Buroja i ka pas 90 kyçe, dhe kontrata tjetër i ka pas 220 kyçe, që janë në përfundim. Të begant dhe jusollt sa vjen uji nuk e di, për arsye së një rezervar i ka 500 litra dhe nuk mundet me furnizua pa ndërpre. Sa i përket asfaltimit të rrugëve, titullin e ka asfaltimi i rrugëve neper fshatra, Klinë, Polac, Makerrmal, Ticë, Kopiliq i Epërm, Rakainic (me grand të performances), nuk e kemi asfaltuar as një vetëm një rrugë në Klinë. Sa i përket kanalizimit në Polac e kemi kanalizimin në lagjen Kodra deri të lagjia Velu e cila ka përfundua vetëm një pjesë të Velu nuk ka përfundua.

Drejtori i DSHMS-së, Shahin Dervishi: Fjala përshëndetëse, sa i përket vërtetim për armbajtje, është që e lëshon Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenie sociale, për të drejtën e zotimit që me pa a është i aftë për mbajtjen e armës.

Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi: Fjala përshëndetëse, në kuadër të punëve të drejtorisë aplikojmë në grande të ndryshme të cilat janë grande të ndryshme të cilat për komuna kemi aplikuar me Bankën botërore, UNDP, UNMIK-un, Qeverinë Japoneze, shumicën e tyre i kemi fituar, ne mesin e atyre projekteve që i kemi fituar është një grand prej UNMIK-ut, që çdo vite hapë thirrje, komunat të ndryshme fitojnë, dhe ne aplikojmë në projektet të ndryshme po edhe në këtë vite aplikojmë prapë dhe janë grande që ju dedikohen komunave, dhe nuk e kemi pa të arsyeshme mos me aplikua.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Besart Rrecaj-PDK: Fjala përshëndetëse, i kam tri çështje që desha me i ngritë, e para ka të bëjë me raportin e kam lexuar dhe e mbështes plotësisht, dhe jam plotësisht i vetishëm që raporti i paraparë nuk ka mundur me u realizua 100%, po janë të vetishëm edhe koleget asamblast, së aty

ku ka pas ngecje nuk kanë mundur me u realizua projektet janë për arsye objektive, qoftë pengesa prej qeveris qoftë mungesë fondesh e gjana tjera. Kështu që përpjekja tina me paraqitë zbehur punën e kryetarit kështu që na e mbështesim me dy duart.

Sa i përket mikut, kojshisë temë që ma kanë lanë afër, që po i bënë gjyq publik drejtoresve, është e papranueshme i përket një partie politike që Ministria e drejtësisë Albulena Hagjiu, Ministri i punëve të brendshme Xhelal Sfeshta, Kryetari i parlamentit Glauk Konjufca, haptas janë paraqit para gjykatës, për mua nuk janë të fajshëm përderisa gjyqësia nuk e jep vendimin e vet. Mirëpo edhe ky nuk lejohet, dhe nuk ka drejtë me bë gjyq publik drejtoresve këtu, nëse drejtoret aktual që janë, e kanë shkelur ligjin, dënohen prej gjykatës e shkojnë në burg si picërraku, po jo mi bë gjyq publik paraprakisht, nuk ka drejt, edhe aty me një arrogancë të jashtëzakonshme këtu me u paraqit një farë terminatori që është edhe e pa edukatë edhe e pa cip. Nëse e kanë votua 40% Albin Kurtin që i ka quajtur njerëzit dhe udhëheqësit hajvana dhe hajvanata, Sami Lushtakun dhe Fadil Nuren, këna me votua deri sa të jenë gjallë.

Mentor Mehmeti-PDK: Fjala përshëndetje, desha të ju përgëzoj për raportin dhe plotësisht mendoj që është e qëlluar që qytetaret ti prekin këto të mira që i ka ky raport dhe gjitha janë përfundua dhe kanë me filluar pavarësisht ngecjeve. Një fjali Hysi e përmendi eutanazinë, besoj që Hysi e kupton po çka është eutanazia d.m.th mbytje me injeksion e zakonisht ndodh të qenet endacak që janë agresiv. Për gjuhen që po përdoret këtu dhe shpresoj të mos përdorën ato gjuhë, fokusoni në punët tjera dhe s'kemi nevojë të merrem me njeri tjetrin.

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, Drejtor, asfaltimi në Klinë të Epërme, unë e di, po është mirë më na thënë kujë ja ke shtrua rrugën me asfalt, i ke shtrua 2km me zhavorr trego sa shtëpi shkojnë aty, dhe ti e din mirë je profesionist, rrugët që i ke shtrua me zhavorr mbi 1km, a ke hapë kanal, sa e ke shtrua trashësinë, dhe perse e ke shtrua asfalt deri të shtëpia i cili nuk jeton askush, e nuk e shtron asfaltin deri të varrezat e fshatit, po e ndalon aty, qysh nuk ju erdh marre. Sa i përket ndriçimit në Klinë të Epërme nuk ka përfundua të njëjtën gjë e keni bë edhe me ndriçim, ja keni dërgua ndriçimin deri të dera militanteve te juve, dhe është mirë drejtor me tregua me emra kuje ja keni dërgua asfaltin dhe ndriçimin deri të dera?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Selim Tahiri-PDK: Fjala përshëndetëse, Naser sa i përket asfaltimit të rrugëve në Klinë të Epërme unë kam pasur shumë vërejtje në qeverisjen e kaluar që ti merr pjesë, dhe kam heshtur, sepse padrejtësitë që janë bë në qeverisjen e kaluar janë shume të mëdhaja ta thamë me fakte. Ti e përmendët këtu janë bë dallime, po dallimet janë shume të mëdhaja në qeverisjen tende, nuk ti kam përmend, e duhet me ti përmend; Në lagjen ton nuk janë shtrua 50m asfalt sepse unë e kam pas shtëpinë në fund të rrugës. Është shtrua asfalt përmbi 100m të shtëpia e Xhafer Ternafcit nuk jeton askush në atë shtëpi. Është shtrua asfalt 200m për një shtëpi, dhe na jemi 12 shtëpi dhe nuk është shtrua asfalt në qeverisjen tende, dhe masë pak keni drejt me fole për kësi dallime, sepse janë bë dallime shume të mëdha nga qeverisja juaj. Nuk pajtona për dallime me asnjë lloj qeverisje, mirëpo na ja kemi lënë kohës, njerëzve me vendos për këtë punë mirëpo janë bë dallime shume të mëdha dhe qytetaret janë qytetar të Skenderajt dhe asnjëherë nuk duhet me punua me mbiemra e me familje dhe është e padrejtë kurdo që është bërë.

Hysni Mehanit-LVV: E para me Besartin nuk merrna, ky e ka një nevojë me ju dëshmuar Samis e Fadilit që është servil i llojit të vetë. Mentor unë e di çka është eutanazia po numri ke shume i madh i qenve të trajtuara me eutanazi. Nuk është bre gjyq publik është një pyetje shume e thjeshtë, shume normale, as nuk thash që jeni fajtor, vetëm thash sa aktakuza, mos me debatua për raportin e punës edhe për aktakuzat që janë bë me relacion me këtë raport pune me thanë mos mi përmend aktakuzat, që janë bë gjatë kryerjes së këtyre punëve, me fal çka doni me i lanë opozitës e me

ardhur me thanë çka doni ju a, unë e di këtë asamble e kemi gjete regjim ushtarak, po mua jo Avdullahi po veç kush ma merr shpirtin ma ndal fjalën.

Kryesuesja: Replikë 1 min.

Naser Bajraktari-IDEAL: Selim faleminderit shume së nuk kam dashur me u marr me ty gjatë këtij mandati, pyetjet ja kam bërë drejtorit, e ti mu përgjigje, ti je asamblist i fshatit Klinë e Epërme, tregomë ti mua për këto 4 vite çka keni bërë në Klinë të epërme, edhe rruga që tu ka shtrua, ti nuk banon atje, banon në Skenderaj, ne mandatin ton nuk kemi këqyrë drejtime partiake, dhe ju keni shtua rrugë vetëm militanteve të juve, dhe nuk i keni shtrua rrugë deri të varrezat e fshatit Klinë e Epërme.

Mentor Mehmeti-PDK: Me thënë numri i madh i qeneve 45 qen brenda vitit, ku ti shohim 45 qen janë në shesh që vinë prej tana aneve, unë e di që disa shoqata kanë dalë me i mbrojte, po trajtimi i qeneve nuk e di qysh behet ndryshe përpos me eutanazi apo një formë tjetër që e përdorshin me vrasje e tyre, unë e di që gjitha komunat e kanë hallin e tyre po Skenderaj ka shume qen me të vërtet.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Naser sa i përket rrugës ka lumi është shtëpia poshtë, sa i përket rrugës nalt është shtëpia nalt, rruga për të varrezat kemi me trajtua edhe masë xhamisë, nuk thash që kanë përfundua dhe ke projekt në vazhdim.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet debatin, shkojmë në votim, Konstatojmë me (16) vota për, (7) kundër dhe (1) abstenim, përkrahët. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës i ekzekutivit për vitin 2024.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës;

-Propozim-vendim për mbështetje financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko-Natyra”, Sh.A. Skenderaj, me Nr.02-404/02-0007012/25, të datës 21.02.2025, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Bazuar në kërkesën e menaxhmentit të Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko-Natyra”, Sh.A. Skenderaj, për mbështetjen dhe zgjerimin e kapaciteteve të punës gjatë vitit 2025, në shumën prej (tridhjetëmijë, euro) 30,000.00€. Mjetet financiare të lartcekura do të paguhen nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë për zhvillim ekonomik ndërmarrësi inovacion dhe turizëm, nga kodi buxhetor 48023.

Kryesuesja: E hap debatin, fjalën ja kaloj;

Afrim Kabashi-NSD: E mbështes këtë propozim vendim, dhe kisha thënë ata punëtor janë nën pagën minimale, e paga minimale është 350€, dhe nëse dikush e meriton me pas pagën me ngritje janë punëtorët e Eko-Natyrës.

Kryesuesja: Armir Sejdiu dhe Ragip Durmishi, bashkëngjitën seancës, fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Drejtor nëse mundesh me na tregua specifikisht perse po kërkohen këto mjete për Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko-Natyra”?

Mentor Mehmeti-PDK: Sa i përket kësaj pike njësoj si Hysi desha me dit pak me shume për çka nevojiten këto mjete? dhe desha ta falënderoj Eko Natyrën që po jepe kontribut për personat me aftësi të kufizuar, ku 4 prej tyre punojnë çdo ditë. Edhe një kërkesë e kisha pas që mos të hedhin mbeturina, e di që është e dhimbshme drejtori i inspektoratit me dënua qytetarin po seriozisht qytetari i Skenderajt e meriton me dënua, me mëngjes pastrohet rruga prej shtëpisë time nga punëtorët e Eko-natyrës, në mes ditë ka të shkoj në shtëpie është plotë mbeturina.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Sa i përket pagës minimale që u përmend tash Eko Natyra e ka menaxhmentin e vet aty edhe financiar, sigurisht që i shtjellon edhe ligjet, dhe me ligj paga minimale nuk duhet të jetë me e vogël se 350€, dhe nëse ka pagë nën 350€ është shkelje ligjore,

po nuk po besoj që ka. Këto mjete nga ndërmarrja po kërkohen sipas kërkesës së menagjimentit që janë të specifikuar në 4 lami që rrjedhin nga plani i punëve të tyre.

Drejtori i DSIIP, Alban Shala: Fjala përshëndetëse, sa i përket kërkesës së Eko Natyrës, për mbështetje financiare, ka me pas rritje gjatë sezonit veror, si rritje të stafit operativ si të punësuarve, si shofer të kategorisë C, dhe sa i përket pagave, pagat janë sipas ligjit dhe nuk ka paga nën 350€, dhe është mbi 350€ e me shume.

Naser Bajraktari-IDEAL: Unë jam për ta mbështetur këto mjete për Eko Natyrën, po desha disa sqarime së është shume e nevojshme, u fol këtu të paga minimale 350€, po nuk duet me fol për pagën 350€, po duhet me fol për një pagë meritorë sepse ata punëtor e bëjnë një punë shume të mirë, edhe kur kërkohen mjete për Eko Natyrën këtu duhet me qenë edhe Bexhet Maliqi sepse është një farë shefi aty edhe me arsyetua, me thanë qekaq kemi pas shpenzime, qikaq punëtor mendojmë me i rritë me kanë me të qartë në kërkesa, së kërkush nuk është mos me i mbështet Eko Natyrën që janë një kategori e shkelur, dhe na jemi për me i mbështet dhe i mbështesim.

Hysni Mehani-LVV: Tash veç sqarim, që e keni emërua një kryeshef ekzekutiv e ka të pa qartë kërkesën drejtor, dua me ditë specifikishte 30mij €, për çka destinohen, sipas drejtorit të financave këto mjete destinohen për 4 pika që janë të shënuar në kërkesë, ti le me nënkuptua që janë për zgjerimin e kapaciteteve, po këto 30mij€, a e ki të qartë për çka destinohen a veç për këto katër pika apo destinohen edhe për çështjet tjera, se nëse e lexon paragrafin 2, e i lexojmë edhe 4 pikat, e nëse e ka pas vetëm këto shërbime, paragrafi 2 nuk ka duft me qenë hiq, veç tregona për çka nevojiten saktë këto 30mij€, a për këto 4 kategori apo për çfarë?

Besart Rrecaj-PDK: E para unë fjalë ofenduese nuk fola, nëse zani naltë pak është ofendim kërkoj falje, e presim transkripton muajin e ardhshëm.

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Kërkesa e kryeshefit të Eko Natyrës është shume e qartë dhe i ka përmend objektivat që dëshiro me i arrit gjatë vitit 2025 të bazuara në Planin e Punës, dhe nuk ka përmend që dojmë me ble asete, vetëm ndonjë aset minimal, si fshisa e diçka të ngjashëm.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet debati, shkojmë në votim, Konstatojmë me (27) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim, miratohet. Propozim-vendim për mbështetje financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale "Eko-Natyrë", Sh.A. Skendera.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës,

-Informatë mbi shërbimet e dhëna nga QKMF, QMF dhe AMF, Janar - Dhjetor 2024, me Nr.08-400/01-0006875/25, të datës 18.02.2025, (Raporton);

Drejtori i DSHMS-së, Shahin Tahiri; Fjala përshëndetëse, Kujdesi parësor shëndetësor ofrohet përmes QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve, për rrethe 52,000 banorëve me një staf prej 184 punëtorëve. Kujdesi parësor shëndetësor në Skenderaj ka të zhvilluar rrjetin organizativ që përbehet nga 1 QKMF, 5 QMF, dhe 8 AMF. Në vitin 2024 e kemi pas numrin e lindjeve me të vogël me 30 lindje vaksinimi i fëmijëve dhe personave mbi 65 vjeç, është kryer në 90%. Raporti i të hyrave mjekësorë është në 18% me i madh së në vitin 2023. Kjo ishte në pika të shkurta sa i përket kësaj informata.

Kryesuesja; E hap debatin, fjalën ja kaloj;

Floriana Halili-LVV: Fjala përshëndetëse, drejtor përse nuk po vazhdoni me i dhënë shtesat për fëmijët e porsalindur?

Hysni Mehani-LVV: Drejtor tash e ke bërë kohen e mjaftueshme me kuptua krejt mënyrën qysh funksionon QKMF-ja. Pyetje që hyn në kuadër të informatës; Sipas ligjit cilat raste lejohet QKMF-së me i ble shërbimet prej një kompanie private? Cili është statusi juridik me cilin operon Kosova Med brenda QKMF-së? Cilat shërbime nuk ka mundur me i dhënë QKMF-ja që ka lind nevojja me kontraktua një kompani private me Kosova Med për me i ofrua këto shërbime cilat shërbime s'ka

mundur me i ofrua QKMF-ja, cilat shërbime i jep Kosova Med? Tash Kosova Med kur jep shërbime i duhen financime, sa është vlera e tenderëve që i ka marrë Kosova Med prej komunës? Sa shërbime do të përmësoheshin brenda QKMF-së nëse Kosova Med që ju kishin dhënë për ato shërbime, që i ka dhënë? Sa mjek dhe infermier janë punësuar nga Kosova Med që operojnë në QKMF, pra punojnë në një institucion publik po janë të punësuar si privat dhe i përdorin resurset publike? Unë e di e kam dërguar një kërkesë në krime ekonomike e di që është hapur një rast nga prokuroria po me duhet një sqarim prej teje, kush janë personat e involvuar edhe a ka rast, kush janë personat që është ngritur kjo aktakuzë dhe cili është rasti ne relacion me këtë. Në opinion është shkarkuar një drejtoresh, dhe ma vonë kanë qarkulluar zërat së arsyeja përse është shkarkuar kjo drejtoresh së përveç kryetarit dhe nënkryetarit ka filluar me kërkua hise në qeta tender që komuna ja ka dhënë Kosova Med-it. A ki informacione sa është hisja që kryetari, nënkryetari dhe drejtoresha që ju ka kërkua Kosova Med-it, me relacionet me tenderët që i ka marr prej komunës?

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Drejtori i DSHMS-së, Shahin Tahiri; Kemi një mori pyetjes, që shumica e tyre nuk kanë të bëjë me informatën, dhe ta bëjë të mundshme me i bë me shkrim dhe të japi përgjigje. Sa i përket shtesave të fëmijëve të porsalindurit një pjesë e tyre është paguar në vitin 2024 kurse pjesa tjetër është kryer në shkurt 2025 dhe çdo kërkesë ka përfundua. Kurse për ligj sa kam njohuri unë këto janë të bazuara në ligjin, shërbimi paliativ nuk është vetëm në komunën tone, po vepron edhe në komunat tjera. Për pyetjet tjera nuk kam përgjigje.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Besart Rrecaj-PDK: Unë jam asamblistë bashke me juve, normal jam servil i Samis e i Fadilit dhe flejë në zyre tyre, po për qudi nuk po e disha që është shkarkuar drejtoresha, a ka mundësi me ma dhënë një fakt pak me ma argumentua? The që ka kërkuar mito, a ka mundësi me pas fakte ma shume, për ndryshe po e denigron, po e nënçmon një zonje një punëtorë të komunës, e që nëse nuk ki fakte definitivisht është e pandershme e pa moralshme dhe nuk është në rregull me u marr me gjana të tilla, po nëse ki fakte për gjana të tilla prej kryetarit urdhëro qiti, e nëse the u ni neper debate neper kafe është për keqardhje.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Me Besartin nuk merrna, drejtor cila është përgatitja profesionale që e ka drejtori aktual i QKMF-së dhe kush është aj?

Drejtori i DSHMS-së, Shahin Tahiri; Nuk është drejtor është U.d. i drejtorit, përgatitja shkollore e tije është Psikolog Klinik.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet debati, shkojmë në votim, Konstatojmë me (18) vota për, (9) kundër dhe (0) abstenim, përkrahet Informatë mbi shërbimet e dhëna nga QKMF, QMF dhe AMF, janardhjetor 2024.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit ditës,

Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme, fjalën ja kaloj,

Sala Jashari-PDK: Fjala përshëndetëse, Kërkesë për DKA-në: Duke vlerësuar përkushtimin dhe angazhimin tuaj për përmirësimin e kushteve në institucionet arsimore, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj një çështje që kërkon trajtim të shpejtë. Në shkollën "Elena Gjika" në Makërmal, mungesa e ujit po krijon vështirësi për nxënësit dhe mësime dhënësit. Furnizimi i rregullt me ujë është një domosdoshmëri për higjienën dhe mirëqenien e fëmijëve, si dhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Besoj se me bashkëpunim dhe përkushtim, mund të gjendet një zgjidhje sa më e shpejtë për këtë problem, duke siguruar një furnizim të qëndrueshëm me ujë për shkollën. Një tjetër çështje që meriton vëmendje është transporti i nxënësve nga fshatrat e largëta. Mungesa e një shërbimi të organizuar të transportit po krijon vështirësi për shumë familje dhe, në disa raste,

mund të ndikojë në largimin e tyre nga zonat rurale. Besoj që ofrimi i një zgjidhjeje për këtë çështje do të lehtësonte prindërit, do të siguronte vijimësinë e arsimit për të gjithë fëmijët dhe do të ndihmonte në ruajtjen e komuniteteve tona. Jam e bindur se me përkushtimin dhe gatishmërinë për zgjidhje që ju keni treguar vazhdimisht, këto sfida do të adresohen sa më shpejt dhe në mënyrë të duhur!

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtorit të DKA-së, Kastriot Duraku: Fjala përshëndetëse, Shkolla e Makermalit Elena Gjika, ujtë ka, në momentin që e kam pranuar pyetjen jam kanë personal e kam vizituar, dhe sipas drejtoreshës së shkollës asnjëherë nuk ka ndërprerje të ujit. Të transporti i fëmijëve diku 40-45 mijë euro në vite janë për transport të fëmijëve diku janë 400 fëmijë, po forma e organizimit është çështje problematike e kompanive të transportit.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Afrim Kabashi-NSD: E kam një kërkesë që seancën e radhës me ardhur me raportua drejtori i bujqësisë Behxhet Maliqi.


Besiana Thaçi-PDK: Fjala përshëndetëse, një kërkesës që e kam pranuar nga punëtori teknik i shkollës fillore Abedin Rexha në Burojë, atje ka mungesë të ujit që 2-3 javë, nëse ka mundësi dikush me intervenua me zgjidh atë problem?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj

Drejtorit të DKA-së, Kastriot Duraku: E kam marr këtë informate nga drejtori i shkollës, realisht pusi i shkollës me ujë, në momentin që është shtruar poligoni sportiv është shtruar mbi pus të ujit, dhe është e pamundur me intervenua aty, dhe kemi bërë kërkesë me hap një pus të ri.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNEA E SKENDERAJT
Kryetari i Komunës
Nr. 02-170/01-001027/25
Data 17 03 2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58 shkronja h), ndërlidhur me nenin 40 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 50 shkronja h), nenit 10 paragrafi 10.5 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2025, të miratojnë këtë:

PROPOZIM

- I. Për miratimin e vendimit për shpalljen e z.Vaughan Smith, “Qytetar Nderi” të Komunës së Skenderajt.
- II. Titulli “Qytetar Nderi”, i ndahet video-gazetarit Britanik, z.Vaughan Smith, në shenjë respekti dhe mirënjohje për kontributin e dhënë në pasqyrimin e realitetit dhe sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar për luftën e popullit shqiptar të Kosovës për liri dhe pavarësi, si: pasqyrimin e Epopesë së UÇK-së në Prekaz, më 5,6 dhe 7 Mars 1998, Masakrës së Abrisë, filmimin e intervistës me heroin Fehmi Ldrovci, incizimin e Parashutistëve Britanikë gjatë ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, si dhe realizimin e filmit të njohur për Luftën e Kosovës, i titulluar “The Valley”, i cili mbetet një ndër dokumentarët më të vlerësuar.
- III. Pas miratimit të vendimit nga Kuvendi i Komunës, Titulli “Qytetar Nderi” i Komunës së Skenderajt, të lartcekurit do t’i ndahet në seancën solemne të Kuvendit të Komunës së Skenderajt, që do të mbahet më 18 Qershor 2025, në Ditën e Çlirimit të Skenderajt.
- IV. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së

Kryetari i Komunës

Fadil Nura



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KRYEVEPI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. 02-352/01-00/0872/25
Data 24 03 2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58, shkronja a) dhe h), nenit 17 shkronja f) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, shkronja a) dhe nenit 15 shkronja f) të Ligjit 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, ndërlidhur me nenin 15, paragrafi 1, pika 8 dhe nenin 34 të Ligjit 04/L-060 për Mbeturina, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, sipas nenit 50 shkronja a) dhe h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, pas shqyrtimit të Kërkesës së KRM “Uniteti” Sh.A – Mitrovicë, Nr. 02-352/10-0008762/25, të datës 03.03.2025, Kryetari i Komunës, i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2025, të miratojnë këtë:

PROPOZIM

- I. Miratimin e vendimit për ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave, të ofruar nga KRM “Uniteti” Sh.A – Mitrovicë, nga 5.00 (pesë) Euro në 6.00 (gjashtë) Euro për ekonomi familjare rezidente, dhe nga 15.00 (pesëmbëdhjetë) Euro në 18.00 (tetëmbëdhjetë) Euro për ekonomi familjare jo-rezidente (ndryshimin dhe plotësimin e nenit 18, paragrafit 1.1, shtojca A, të Rregullores Nr. 01-110/04-0005958/23, dt. 31.01.2023 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Skenderajt).
- II. Miratimi i vendimit të cekur në pikën I, propozohet në bazë të kërkesës së KRM “Uniteti” Sh.A – Mitrovicë, bashkëngjitur këtij propozimi.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesuses së KK-së



Për:	z. Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderajt
Nga:	z. Ylber Murtezaj, U.D. Kryeshef Ekzekutiv KRM "Uniteti" Sh. A
Lënda:	Kërkesë për ngritje të tarifës për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave
Datë:	03.03.2025

I nderuari Kryetar z. Fadil Nura,

Kompania Regionale për Grumbullimin e Mbeturinave "Uniteti" Sh. A Mitrovicë, është ndërmarrje Publike me vetfinansim e specializuar dhe e licencuar për kryerjen e shërbimeve me rëndësi të veçantë shoqërore për bartjen e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjienës publike. KRM "Uniteti" Sh. A, operon me shërbimet e veta në Komunitet Mitrovicë dhe Skenderaj.

Tash e dy (2) vite, për shërbimet primare të menaxhimit të mbeturinave në territorin administrativ të Komunës së Skenderajt, ekonomitë familjare rezidente për shërbimin e ofruar në grumbullim të mbeturinave sipas kategorisë derë më derë e po ashtu edhe me kontejner të përbashkët (1.1 m³) ngarkohen me tarifë prej 5.00 €, derisa ekonomitë familjare jo-rezidente ngarkohen me tarifë prej 15.00 €, shumë kjo e cila duke marrë për bazë gjendjen e vështirë financiare të Njësive Punuese në Skenderaj, e cila në bazë të hyrave të cilat i gjeneron nga shërbimet e ofruara nuk ka hapësirë që të mbulojë shpenzimet e derivateve, pjesëve rezervë për automjete e shpenzime tjera operative të cilat krijohen gjatë përmbushjes së detyrave në grumbullim të mbeturinave.

Poashtu, shpenzimet më të mëdha për Njësine Punuese në Skenderaj krijohen kryesisht nga distanca e madhe e fshatrave nga qendra e qytetit që nënkupton për të arritur deri tek fshati më i largët i komunës së Skenderajt, në mënyrë që të kryhet shërbimi, shumëherë shpenzimet e krijuara janë më të mëdha sesa përfitimi i cili do të realizohej me kryerjen e këtij shërbimi. Gjithashtu, duke pasur parasysh faktin se deponia "Gërmova" është rreth 30 km larg qytetit të Skenderajt krijohen shpenzime shtesë edhe për shkak të kësaj distance.

Duke u nisur nga fakti se standardi i jetesës ka ndryshuar, ngritja e vazhdueshme e çmimeve të tregut e posaçërisht e derivateve dhe pjesëve rezervë për kamion, kërkesës së vazhdueshme të ngritjes së pagave nga punëtorët dhe arsyeve tjera të shumta, mendojmë se kërkesa jonë është e bazuar dhe e arsyeshme.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A, Mitrovicë

Realizimi i kësaj kërkesë ka ndikim pozitiv në Kompani duke rritur performancën e punës si dhe ngritjen e vullnetit për punë nga ana e punëtorëve pasi që do të ndikonte në përmirësimin direkt të mirëqenies së tyre.

Prandaj, kërkojmë nga Komuna e Skenderajt që të bëjë ngritjen e tarifës për ekonomi familjare rezidente nga 5.00 € në 6.00 €, derisa për ekonomi familjare jo-rezidente nga 15.00 € në 18.00 €.

Paraprkisht ju falënderojmë për mirëkuptim!